


ZYRTARËT POLICORË PO VAZHDOJNË TË QËNDROJNË AFËR NDËRTESËS SË KOMUNËS SË ZVEÇANIT, TË LEPOSAVIQIT DHE TË ZUBIN POTOKUT IFAQE 4-5

NGJARJET E FUNDIT NË VERI 'PËRPLASIN' KOSOVËN ME SHBA-në



Deklarata e sekretarit amerikan të Shtetit, Antony Blinken, se "i dënon fuqishëm veprimet e Qeverisë së Kosovës në veri që, sipas tij, po përshkallëzojnë tensionet në këtë pjesë dhe po shtojnë jostabilitetin", ka ngjallur reagime brenda dhe jashtë vendit. Kryeministri Albin

Kurti ka thënë se janë të vetëdijshëm dhe i kuptojnë shqetësimet e ngritura nga partnerët ndërkombëtarë por, sipas tij, çdo opsion tjetër do të ishte mospërbushje e obligimeve kushtetuese të Qeverisë së Kosovës ndaj kryetarëve të rinj. Dy

kongresmenë amerikanë, Zach Nunn dhe Richie Torres, nuk janë pajtuar me deklaratën e Blinkenit, duke bërë thirrje që ShBA-ja të qëndrojë me Kosovën. Ndërkaq të dielën për vizitë ka ardhur në Kosovë raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian

AKTUALE



RAMA DHE OSMANI E UROJNË ERDOGANIN PËR FITOREN F.2

SHTËPIA E BARDHË DHE REPUBLIKANËT ARRIJNË MARRËVESHJE PËR TAVANIN E BORXHIT F.7

AMBASADORËT E AKREDITUAR NË KOSOVË VIZITOJNË OBJEKTET KULTURORE NË GJAKOVË F.6

EKONOMI



A MUND TË HYJË EKONOMIA E KOSOVËS NË RECESION? F.8

SPORT



BALKANI FESTON TITULLIN, TREPÇA'89 DHE DRENICA BIEN NGA SUPERLIGA F.14

ERDOGANI FITON ZGJEDHJET PRESIDENCIALE

Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka shpallur fitoren në balotazhin presidencial të mbajtur të dielën. Erdogan, që fitoi për të tretën herë drejtimin e Turqisë, bëri deklaratat e para pas mbylljes së qendrave të votimit dhe

foli para mbështetësve në një autobus jashtë shtëpisë së vet në Stamboll: "Falënderoj çdo qytetar të këtij vendi që më besoi përgjegjësinë për ta qeverisur këtë vend edhe një herë për pesë vitet e ardhshme"



RENOVA
PUTZ
Mqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mbx: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Erdogani fiton zgjedhjet presidenciale

Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka shpallur fitoren në balotazhin presidencial të mbajtur të dielën. Erdogan, që fitoi për të tretën herë drejtimin e Turqisë, bëri deklaratat e para pas mbylljes së qendrave të votimit, dhe foli para mbështetësve në një autobus jashtë shtëpisë së vet në Stamboll: “Falënderoj çdo qytetar të këtij vendi që më besoi përgjegjësinë për të qeverisur këtë vend edhe një herë për pesë vitet e ardhshme”



STAMBOLL, 28 MAJ - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka thënë të dielën se populli turk i ka dhënë atij përgjegjësinë për të qeverisur në pesë vjetet e ardhshme, duke shpallur fitoren në raundin e balotazhit të zgjedhjeve presidenciale. Duke folur para mbështetësve në Stamboll, Erdogan, që e ka udhëhequr Turqinë për dy dekada, falënderoi qytetarët që votuan dhe tha se me votën e tyre ai ka mposhtur në zgjedhje kundërkandidatin nga opozita, Kemal Kilicdaroglu. Sipas rezultatit paraprakë jozyrtarë të njoftuara nga agjencitë turke të lajmeve, presidenti Erdogan kryeson rezultatin e zgjedhjeve ndërsa janë numëruar 98 % të votave të balotazhit presidencial. Sipas agjencisë shtetërore të lajmeve “Anadolu”, Erdogan ka

siguruar 52.1 % të votave, ndërsa rivali i tij, Kemal Kilicdaroglu, 47.9%. Ndërkohë, sipas agjencisë së lajmeve ANKA, e afërt me opozitën, rezultati i votimit ishte 51.9 % për Erdoganin dhe 48.1 % për Kilicdaroglu. Mbi 60 milionë persona kishin të drejtë vote në zgjedhjet e së dielës. Qendrat e votimit për raundin e balotazhit u hapën në orën 08:00, sipas kohës lokale, dhe u mbyllën në orën 17:00. Sipas Anadolu, dalja në raundin e dytë të zgjedhjeve është 4 për qind më e lartë se në raundin e parë, përkatësisht 84-85 për qind. Mbi 400 000 vullnetarë nga partitë opozitare kanë monitoruar procesin e votimit dhe të numërimit të votave. Në raundin e parë të zgjedhjeve

presidenciale, që u mbajtën më 14 maj, Erdogan doli i pari, duke fituar 49.5 për qind të votave, ndërkaq Kilicdaroglu arriti të merrte 44.9 për qind të votave. Kjo ishte hera e parë në 20 vjet sa është në pushtet që Erdogan nuk fitoi zgjedhjet në raundin e parë. Pas votimit në raundin e balotazhit, Kemal Kilicdaroglu u bëri thirrje votuesve “që ta largojmë këtë regjim autoritar”. “Unë ju urdhëroj që ta heqim këtë regjim autoritar... Ftoj të gjithë qytetarët e mi të votojnë”, tha ai pasi votoi në Ankara. Ndërkaq, Erdogan bëri thirrje “për një pjesëmarrje në zgjedhje, pa ankesa”, pasi votoi me bashkëshorten e tij, Eminen, në Stamboll. Deklarata të ngjashme të dy kandidatët bënë edhe një ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.

Opozita i ka parë zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare të majit, si mundësinë më të mirë për të rrëzuar nga pushteti Erdoganin dhe për të hequr dorë nga ndryshimet që presidenti turk ka bërë në shtet. Dy kandidatët përqendruan fushatën për balotazh në përpjekjet për të bindur rreth 8 milionë votues, që nuk votuan në raundin e parë të zgjedhjeve. Në zgjedhjet e 14 majit, përveç zgjedhjeve presidenciale, u mbajtën edhe ato parlamentare, dhe partia e Erdoganit, Partia për Drejtësi dhe Zhvillim (AK), fitoi shumicën parlamentare. Erdogan më herët gjatë kësaj jave mori mbështetje nga Sinan Ogan, politikani nacionalist që doli kandidati i tretë në raundin e parë. Ogan, që tha se do ta mbështesë Erdoganin në balotazh, i cili në raundin e parë

të zgjedhjeve arriti të merrte 5.2 për qind të votave.

Rama dhe Osmani e urojnë Erdoganin për fitoren

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në “Facebook” e ka uruar Rexhep Tajip Erdoganin për fitoren në raundin e dytë të zgjedhjeve në Turqi. “Urime për fitoren z. Presidenti!”, ka shkruar Rama. Edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka uruar homologun turk për fitoren. “I shprehim urimet tona të përzemërta presidentit Erdogan në fitoren e sotme. Ndërsa ju vazhdoni ta udhëhiqni Turqinë drejt sukseseve të reja. Mezi pres të punojmë së bashku për të ndërtuar mbi bashkëpunimin tonë të shkëlqyer”, ka deklaruar Osmani teksa ka shkruar edhe në gjuhën turke.

Rusia kryen sulme masive me dronë në Kiev


KIEV, 28 MAJ - Forcat ruse kanë shënjestruar Kievin me një valë të madhe të sulmeve ajrore mëngjesin e 28 majit, thanë zyrtarët ukrainas, duke e përshkruar si sulmin “më të madh” me dronë ndaj këtij qyteti që nga nisja e luftës. Sulmet ajrore vijnë në kohën kur shënohet Dita e Kievit, apo 1 541-vjetori i themelimit të qytetit.

Sistemet e mbrojtjes ajrore të Ukrainës kanë rrëzuar të paktën 40 dronë, ndërkaq rrëzimi i tyre ka vrarë të paktën një person dhe plagosur dy të tjerë, thanë zyrtarët. Serhiy Popko, kreu i administratës ushtarake të Kievit, tha se Rusia ka përdorur dronët e prodhimit iranian Shahed për të kryer

sulmet në Kiev, që është qyteti më i populluar në Ukrainë, me rreth 3 milionë banorë. “Sot armiku vendosi ta ‘uronte’ popullin e Kievit për Ditën e Kievit me ndihmën e dronëve të tij vdekjeprurës”, shkroi Popko në Telegram. “Sulmi u krye përmes disa valëve dhe sirenat e alarmit zgjatën mbi pesë orë”, shtoi ai.



Shqipëri, shumë turistë e pak punëtorë



TIRANË, 28 MAJ - Në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë, çdo ditë mund të shohësh grupe me turistë të huaj. Pavarësisht prej rritjes së numrit të turistëve, industria e turizmit në Shqipëri po përballlet me mungesë të fuqisë punëtore.

Turistët e huaj kryesisht vizitojnë disa prej atraksioneve kryesore turistike të Tiranës, sikurse Muzeun Historik Kombëtar, Kullën e Sahatit, Xhaminë e Et'hem Beut, fotografohen para monumentit të heroit kombëtar shqiptar Gjergj Kastrioti Skënderbeu si dhe vizitojnë BunkArt2, që në periudhën e regjimit komunist ka qenë bunker kundërbërthamor i Ministrisë së Brendshme. Ata, po ashtu, vizitojnë edhe vijën bregdetare shqiptare.

“Radio Evropa e Lirë” ka biseduar me disa prej turistëve të huaj të cilët kanë treguar se çfarë u pëlqen dhe çfarë jo në Shqipëri.

Ankesa për cilësinë e shërbimeve

“Jam për herë të parë në Shqipëri dhe më pëlqen shumë. Më pëlqen natyra dhe ushqimi,

por negativ është fakti se pak njerëz dinë të komunikojnë në anglisht derisa na shërbejnë”, tha për “Radion Evropa e Lirë”, Marina Kataschlaga nga Austria, e cila vizitoi Xhaminë e Et'hem Beut në Tiranë.

Ndërkaq, Mishel nga Austria, para se ta vizitonte Tiranën, kishte qëndruar në jug të Shqipërisë, në Ksamili, që tha se ishte një vend shumë i bukur. Megjithatë, ajo pati ankesa për shërbimin. “Restorantet dhe hotelet janë vërtet të mira, por stafi ka shumë problem në komunikimin me turistët e huaj. Infrastruktura rrugore është gjithashtu problem. Megjithatë më pëlqen Shqipëria dhe do të kthehem sërish”, tha kjo turistë. Raiza nga Indonezia tha se Shqipëria i ngjan shumë shtetit të saj sa iu përket rrugëve dhe trafikut. Pavarësisht se vlerëson pastërtinë, ajo përmendi problemet që ka pasur me shërbimin në hotel për shkak të numrit të vogël të punëtorëve. “Po shkonim në dhomën tonë në katin e 12-të, dhe stafi ishte pak rrëmujë, pak agresiv duke sistemuar valixhet, ndërsa prisnim ta merrnim ashensorin. Gjithashtu kam pasur vështirësi të komunikoj për shkak se kuptonin pak anglisht”, tha ajo.

Mbi 50 për qind më shumë turistë

Sipas raportit të fundit të Institutit të Statistikave (INSTAT), të publikuar më 25 maj, turizmi në Shqipëri ka shënuar rritje. “Gjatë muajve janar-prill Shqipërinë e vizituan rreth 1.7 milion të huaj që, krahasuar me të njëjtën periudhë të një vitit më parë, është 57 për qind më shumë”, u tha në raport.

Nga kompanitë turistike thanë se ka fluks turistësh dhe ka rezervime për muajt e verës, por ajo që i mundon është përballimi i kësaj situate për shkak të mungesës së fuqisë punëtore. Ferioli Ozuni, ekspert i turizmit, njëherësh drejtues i një agjenci turistike, tha se gjetja e stafit të kualifikuar apo gjysmë të kualifikuar paraqet sfidë të madhe. “Industria e turizmit ka nevojë për të paktën 35 për qind më shumë staf, pasi kjo lloj industrie jep garanci për një periudhë sezonale. Jemi të detyruar të marrim staf të papërgatitur, që gjë cenon cilësinë e shërbimeve, por nuk kemi zgjidhje tjetër për disa shërbime. Pra, siç thuhet në gjuhën popullore, po bëjmë armime, po përpiqemi t'i mbushim

boshllëqet me lloj-lloj mënyrash”, tha Ozuni.

Ai theksoi se për shkak se nuk arrijnë të punësojnë staf të kualifikuar, detyrohen që disa prej anëtarëve të stafit t'i shndërrojnë në “trajnuar” për punëtorët e tij. “Unë vuaj për shoferë të autobusëve pasi organizojë turne të ndryshme dhe nuk mund të marr në punë persona të pakualifikuar dhe t'i trajnoj sepse kërkon shumë kohë. Jam detyruar që të bëj vetë shoferin, por edhe guidën turistike në disa raste, me disa grupe turistësh vendas dhe të huaj. Janë kontrata që janë firmosur disa muaj më parë dhe nuk e parashikon se si të vjen situata dhe gjendesh pa punëtorë. Pra, unë drejtues kompanie detyrohem të bëj edhe këto punë. Përgjegjësitë e mia janë të mëdha duhet të jem në kontakt me partnerë, klientë etj. Kjo ka ndodhur me shumë kolegë të mi për shkak të mungesave të shumta që kemi në staf”, tregoi ai. Edhe pse institucionet shtetërore e kanë vendosur si prioritet turizmin, Ozuni tha se nuk sheh se është bërë diçka në këtë drejtim. Ai tha se shkollat e mesme profesionale apo universitetet nuk janë të orientuara drejt nevojave të tregut të punës.

“Zgjidhje urgjente, jo afatgjatë”

Besnik Vathi nga Shoqata e Hoteleri-Turizmit tha për “Radion Evropa e Lirë” se mungesa e fuqisë punëtore është problemi kryesor i turizmit në prag të nisjes së sezonit të verës. “Është shumë vonë për të gjetur një zgjidhje tani. Duhet të ishin marrë masa shumë kohë më herët me politika konkrete afatgjatë. Për këtë sezon kjo kosto i mbetet biznesit, që ka marrë masat për trajnime individuale, ndërsa po përpiqet të gjejë punëtorë të kualifikuar si nga Turqia, edhe nga Serbia, Maqedonia e Veriut për të sjellë punëtorë të kualifikuar, që ky sezon me fluks në rritje të përballohet me sukses. Tani biznesi duhet të shohë për zgjidhje urgjente jo afatgjatë”, tha Vathi. Ai shtoi se industria e turizmit në Shqipëri ka mungesë të kuzhinierëve, kamerierëve e deri te shoferët.

Sipas raportit të publikuar nga INSTAT, numri i turistëve të huaj këtë vit është më i larti në shtatë vjetet e fundit. Ky institucion ka paralajmëruar se do të ketë rritje të vizitorëve të huaj në Shqipëri gjatë verës, gjë që udhëheqësit në industrinë e turizmit thanë se do të paraqesë një sfidë të madhe për ta.



ZYRTARËT POLICORË PO VAZHDOJNË TË QËNDROJNË AFËR NDËRTESESË SË KOMUNËS SË ZVEÇANIT, TË LEPOSAVIQIT DHE TË ZUBIN POTOKUT

Ngjarjet e fundit në veri 'përplasin' Kosovën me ShBA-në

Deklarata e sekretarit amerikan të Shtetit, Antony Blinken, se “i dënon fuqishëm veprimet e Qeverisë së Kosovës në veri që, sipas tij, po i përshkallëzojnë tensionet në këtë pjesë dhe po shtojnë jostabilitetin”, ka ngjallur reagime brenda dhe jashtë vendit. Kryeministri Albin Kurti ka thënë se janë të vetëdijshëm dhe i kuptojnë shqetësimet e ngritura nga partnerët ndërkombëtarë por, sipas tij, çdo opsion tjetër do të ishte mospërbushje e obligimeve kushtetuese të Qeverisë së Kosovës ndaj kryetarëve të rinj. Dy kongresmenë amerikanë, Zach Nunn dhe Richie Torres, nuk janë pajtuar me deklaratën e Blinkenit, duke bërë thirrje që ShBA-ja të qëndrojë me Kosovën. Ndërkaq të dielën për vizitë ka ardhur në Kosovë raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 28 MAJ - Policia e Kosovës ka bërë me dije të dielën se situata në veri është stabile dhe se zyrtarët policorë po vazhdojnë të qëndrojnë afër ndërtesës së komunës së Zveçanit, të Leposaviqit dhe të Zubin Potokut.

Më 26 maj në këto tri komuna grupe të serbëve lokalë u përleshën me Policinë e Kosovës, e cila asistoi kryetarët e rinj shqiptarë që të hynin në zyrat e tyre. Ndërtesat e këtyre komunave paraprakisht janë përdorur nga strukturat paralele serbe.

Autoritetet në Kosovë kanë mbrojtur vendimin e tyre që kryetarët e rinj të veriu të hynin në zyrat e tyre. Por,

faktori ndërkombëtar e cilësoi shkuarjen në komunat në veri të kryetarëve të rinj si “hyrje me forcë”, duke i dënuar veprimet e Prishtinës.

Deklarata e sekretarit amerikan të Shtetit, Antony Blinken, se i “dënon fuqishëm veprimet e Qeverisë së Kosovës në veri që, sipas tij, po përshkallëzojnë tensionet në këtë pjesë dhe po shtojnë jostabilitetin”, ka ngjallur reagime brenda dhe jashtë vendit.

Blinken ka thënë se këto veprime janë marrë “në kundërshtim me këshillat e Shteteve të Bashkuara dhe partnerëve evropianë të Kosovës”. “Këto veprime i kanë përshkallëzuar tensionet pa nevojë, duke i minuar përpjekjet për të ndihmuar në normalizim të marrëdhënieve

në mes të Kosovës dhe Serbisë. Këto veprime do të rezultojnë me pasoja në marrëdhëniet tona bilaterale me Kosovën. Ne i bëjmë thirrje kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, që ta ndryshojë kursin në të gjitha drejtimet dhe të përmbahet nga veprimet e tjera që mund t'i rritin tensionet dhe të promovojnë dhunë”, ka thënë Blinken.

Kryeministri Albin Kurti ka thënë se shkuarja e kryetarit të komunës në vendin e tij të punës do të duhej të ishte gjëja më normale e mundshme. “Ne jemi të vetëdijshëm dhe i kuptojmë shqetësimet e ngritura nga partnerët tanë ndërkombëtarë, por çdo opsion tjetër do të ishte mospërbushje e obligimeve kushtetuese të qeverisë sonë

ndaj kryetarëve të rinj; do të ishte mospërbushje e obligimeve dhe detyrimeve të kryetarëve të rinj ndaj qytetarëve të Republikës; dhe, do ta pamundësonte ofrimin e shërbimeve bazike komunale për qytetarë. Andaj, si kryeministër i të gjithë qytetarëve, i ftoj të gjithë, veçanërisht qytetarët serbë të Kosovës, të bashkëpunojnë me kryetarët e rinj dhe kabinetet e tyre, të cilat do të jenë multietnike, multikulturore, multigjuhësore dhe multipartiake. Ata janë të zgjedhur dhe nuk janë kundër askujt, por në shërbim të të gjithëve”, ka thënë Kurti.

Dy kongresmenë amerikanë nuk janë pajtuar me deklaratën e Blinkenit. “ShBA: Qëndroni me Kosovën, një demokraci të re dhe një aleat të palëkundur të ShBA-së - të dyja duke u vendosur jashtë vendit dhe duke mirëpritur të evakuuarit afganë (një nga miqtë e vetëm evropianë)”, ka shkruar në “Twitter” kongresmeni republikan Zach Nunn. Ai ka shtuar se sekretari Antony Blinken duhet t'i kundërvihet mobilizimit ushtarak të Serbisë. “Sekretari Blinken duhet t'i kundërvihet mobilizimit ushtarak të Serbisë”, ka përfunduar ai.

Edhe kongresmeni amerikan Richie Torres ka shprehur zhgënjimin e tij me deklaratën e Blinkenit në lidhje me ngjarjet e së premtes në veri të Kosovës. Ai tha se Kosova është aleat i palëkundur dhe se ishte ndër vendet e para që pranoi refugjatët afganë për llogari të ShBA-së. “Kosova është një aleat i palëkundur i ShBA-së. Kur ShBA-së i duheshin shtete për të pranuar refugjatët afganë, Kosova ishte e para dhe ndër të paktat që pranoi. Është zhgënjyese për mua dhe për votuesit e mi shqiptarë ta shohë sekretarin Blinken të sulmojë publikisht një aleat të ShBA-së”, ka shkruar Torres në “Twitter”, duke e rishpërndarë deklaratën e Blinkenit.

Kurti pret Cramonin në zyrë, temë veriu

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga deputetja e Kuvendit të Kosovës, njëherësh kryetarja e Komisionit Parlamentar për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, Fitore Pacolli Dalipi, të dielën në mëngjes takoi raportuesen për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon, e shoqëruar nga

kryetarja e Komisionit Parlamentar për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, Fitore Pacolli Dalipi, të dielën në mëngjes takoi raportuesen për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon, e shoqëruar nga shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomáš Szunyog dhe bashkëpunëtorë të tjerë.

Biseduan për zhvillimet në vend, me theks për procesin e dialogut në Bruksel dhe marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe për procesin pas-zgjedhor në katër komunat në veri të vendit.

Kryeministri rikujtoi se zgjedhjet në katër komunat në veri të vendit ishin shtyrë një herë në dhjetor dhe se tani pas mbajtjes së tyre më 23 prill, “është e rëndësishme të fillojmë sa më parë ofrimin e shërbimeve bazike për qytetarët të cilat kanë munguar që nga fillimi i muajit nëntor të vitit të kaluar pas dorëheqjes së kryetarëve pararendës”. Ndërsa për sa i përket dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian dhe Marrëveshjes Bazike dhe Aneksit të Zbatimit të saj, ai përsëriti që duhet zbatim i shpejtë, i plotë dhe i pakushtëzuar.

Kryeministri shtoi që ishte kënaqësi ta priste Cramonin në takim në këto kohë të rëndësishme dhe e falënderoi atë për përkrahjen për anëtarësim në Këshillin e

Evropës dhe Bashkimit Evropian.

Të shtunën i dërguari i Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin, arriti në Kosovë për takime me udhëheqës të qeverisë, forcave paqeruajtëse të NATO-s, EULEX-it dhe serbëve lokalë për të diskutuar për situatën. “Ne e dënojmë vendimin e Kosovës për të hyrë me forcë në ndërtesat komunale në veri dhe reagimet e dhunshme”, ka theksuar Sarrazin, duke bërë thirrje për vetëpërbajtje nga të gjitha palët dhe përkushtim nga Kosova dhe Serbia për t'i zbatuar menjëherë marrëveshjet e arritura.

Von Cramon: Kosova nuk ka legjitimitim për të hyrë në ndërtesat komunale në veri

Raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon, ka vizituar të dielën veriun. Ajo ka thënë se e kupton që kryetarët e rinj shqiptarë të komunave në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe, mund të kenë të drejtë të ushtrojnë funksionet e tyre. Megjithatë, von Cramon ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se nëse hyrja e tyre në ndërtesat komunale do të bëhet vetëm me praninë e forcave policore të armatosura rëndë, atëherë ata kanë “zero legjitimitim politik”. “Mendoj se shumë

NATO dhe BE: Kosova të mos ndërmarrë hapa të njëanshëm dhe destabilizues

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, dhe shefi i diplomacisë së Bashkimit Evropian, Josep Borrell, kanë kërkuar nga Kosova ta shtensionojë situatën dhe të mos ndërmarrë “hapa të njëanshëm dhe destabilizues”. Stoltenbergu tha se ka biseduar me përfaqësuesin e lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri të Bashkimit Evropian, Josep

Borrell, lidhur me situatën në Kosovë, pas rritjes së tensioneve në veriun e banuar me shumicë serbe. “Bisedova me përfaqësuesin e lartë Josep Borrell lidhur me Kosovën. Prishtina dhe Beogradi duhet të angazhohen tani në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja, si rruga e vetme drejt paqes dhe normalizimit. Prishtina duhet ta shtensionojë situatën dhe

mos të ndërmarrë hapa të njëanshëm, hapa destabilizues. Misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, do të vazhdojë të ofrojë mjedis të sigurt”, ka shkruar ai në “Twitter”. Ndërkaq Borrelli tha se e mirëpret koordinimin e mirë midis misionit të BE-së në Kosovë për Sundim të Ligjit (EULEX) me KFOR-in për të ofruar mjedis të sigurt në Kosovë.

gjëra shkojnë keq në këtë shtet nëse ky është realiteti, nëse shohim makina të blinduara, policë të armatosur rëndë, njësi speciale që 24/7 ruajnë ndërtesat komunale, ne vërtet duhet të mendojmë për mundësi të tjera dhe opsione të tjera. Kjo nuk është ajo që ne dhe BE-ja kemi në mendje. E di që është situatë e vështirë, siç e kam thënë më parë. Qeveria mund të ketë diçka tjetër në mendje, por si e zbatoi atë, nuk është në linjë me gjithçka, të paktën ne në BE do të donim të shihnim”, thotë ajo.

Sipas zyrtares së lartë evropiane, duhet një zgjidhje që do të përfshinte edhe banorët lokalë, pas rritjes së

tensioneve në veri të Kosovës, kur grupe të serbëve lokalë më 26 maj kundërshtuan hyrjen në ndërtesa komunale të kryetarëve të rinj shqiptarë të Zveçanit, Leposaviqit dhe Zubin Potokut. Policia e Kosovës asistoi hyrjen e tyre në zyra dhe u përlesh me serbët lokalë, të cilët hodhën gurë në drejtim të forcave policore. Policia u kundërpërgjigj me shok-bomba dhe gaz lotsjellës, teksa u raportua se pesë policë u lënduan dhe disa makina të tyre u dogjën. “Ne nuk mund thjesht ta zbatojmë të drejtën për të hyrë në një ndërtesë komunale, edhe nëse de jure keni të drejtë të bëni një gjë të tillë. Por, de facto, nuk mendoj

se ka legjitimitim për të bërë diçka të tillë”, është shprehur Viola von Cramon.

Ajo u pyet nëse është takuar me përfaqësuesit e Listës Serbe, por u shpreh se nga kjo parti kanë refuzuar që të takohen me të. “Në mëngjes jam takuar me shumë përfaqësues por, fatkeqësisht, Lista Serbe ka refuzuar të më takojë. Nuk e di arsyen për këtë. Do të isha shumë e lumtur që të takohesha me ta”, thotë ajo.

Në katër komunat në veri të Kosovës, në zgjedhjet lokale të 23 prillit, u zgjedhën katër kryetarë të rinj shqiptarë, pasi në këto zgjedhje të jashtëzakonshme nuk morën pjesë partitë serbe.



Ambasadorët e akredituar në Kosovë vizitojnë objektet kulturore në Gjakovë

GJAKOVË, 28 MAJ - Kryetari i komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, në fundjavë ka pritur në qytetin e Gjakovës ambasadorë të vendeve të ndryshme të botës të cilët veprojnë në Kosovë. “Bashkë vizituam objekte kulturore, historike dhe fetare në pjesë

të ndryshme të qytetit tonë, përfshirë Çarshinë e Vjetër, duke i informuar ata për kulturën dhe traditën e Gjakovës. Gjithashtu, bëmë edhe një ecje përgjatë shëtitores së lumit Krena. Kjo vizitë u organizua nga Ambasada e Shqipërisë në

Kosovë në bashkëpunim me komunën e Gjakovës. Faleminderit ambasadorëve për këtë vizitë, në veçanti ambasadorit të Shqipërisë, Qemal Minxhozi, për angazhimin e tij për këtë organizim”, ka shkruar Gjini në “Facebook”.



Përkujtohen dëshmorët që ranë heroikisht në Betejën e “Mileskës”



RAHOVEC, 28 MAJ - Të dielën janë përkujtuar dëshmorët që ranë heroikisht në Betejën e “Mileskës”. Më 28 maj 1999 ranë dëshmorë komandant Mensur Zyberaj - 500-shi, Habib Gashi nga Nagaci, Ismail Gashi nga Krusha e Madhe, Bedri Berisha nga Volljaka e Klinës, Nazmi Hasani e Kurtish Hasani nga Randobrava e Prizrenit. Në pllakën përkujtuese janë

edhe emrat e luftëtarëve, dëshmorëve të lirisë, Rifat Dinës nga Celina dhe Çausht Berishës nga Brestoci.

Kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, ka thënë se Krusha e Madhe, Nagaci, Drenoci, Rahoveci dhe çdo vendbanim i kësaj zone dhe e tërë Anadrinia, luajtën rol të jashtëzakonshëm në luftën për liri. “Jemi vrarë e jemi burgosur, na kanë përzënë e kanë

planifikuar ta lënë këtë tokë pa shqiptarë, por nuk kanë arritur kurrë, sepse në dhimbjet e mëdha kemi gjetur forcën për t’u rilindur e luftën s’e kemi ndalur. Kjo tokë u la me gjak, me gjakun e kuq të trimave që as nuk qahen e as nuk vajtohen, për veprën e cila jeton e gjallë midis nesh, ashtu si do të rrojë përjetë vepra e tyre luftarake dhe lirisdashëse”, u shpreh kryetari Smajl Latifi.

Promovohet harta e ekoturizmit në Podujevë

PODUJEVË, 28 MAJ - OJQ Sundimi i Demokracisë në Kosovë (SDK) ka promovuar hartën e ekoturizmit në komunën e Podujevës në të cilin aktivitet mori pjesë edhe kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi. Bulliqi e ka përgëzuar organizatën SDK për punën e mirë që po bën për promovimin e ekoturizmit dhe përgatitjen e hartës për potencialin e ekoturizmit në komunën e Podujevës, e cila do të shërbejë në të ardhmen për zhvillim të turizmit. Me këtë rast u zhvillua edhe

aktiviteti i ciklizmit me moton “Ngisni biçikletën, ruani planetin dhe shëndetin”. Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit “Qasje miqësore ndaj mjedisit përmes promovimit të ekoturizmit”, që mbështetet në kuadër të projektit “Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2 - ReLOaD2”, i cili financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe komuna e Podujevës dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).



Së shpejti nis ndërtimi i dy shkollave në lagjet Mati 1 dhe Sofali



PRISHTINË, 28 MAJ - Në Prishtinë së shpejti do të nisë ndërtimi edhe i dy shkollave të reja. Ndërtimi i tyre sipas planit të komunës do të bëhet në lagjen Sofali dhe Mati 1. Kështu ka konfirmuar për Telegrafin drejtoresha e Arsimit në komunën e Prishtinës, Besiana Musmurati. “Shumë shpejt do të fillojë ndërtimi i shkollës Mati 1 dhe në Sofali. Do t’ju ftojme së shpejti kur e vejmë themelin”, tha shkurtimisht ajo. Komuna e Prishtinës para disa muajsh kishte nënshkruar

kontratën për ndërtimin e tri shkollave të reja dhe mirëmbajtjes së tyre në periferi të Prishtinës: Sofali, Mat dhe Prishtina e Re. Ndërsa ndërtimi i shkollës në Veternik ka nisur para tri javësh. Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë se kjo shkollë është shumëpritur nga të gjithë banorët e zonës Prishtina e Re. Ai, gjithashtu, ka deklaruar se shkolla do të ketë kapacitet për 1 080 nxënës, duke ofruar shkollim nga niveli parashkollor deri te klasa e 9.

19 organizata joqeveritare dhe klube sporti përfitojnë subvencionim nga komuna e Deçanit

DEÇAN, 28 MAJ - Nëntëmbëdhjetë organizata joqeveritare dhe klube sportive, që veprojnë në komunën e Deçanit, kanë përfituar subvencionim nga

kjo komunë. “Kemi bërë nënshkrimin e marrëveshjeve me përfaqësuesit e Klubeve Sportive dhe OJQ-të përfituese të thirrjes publike për subvencionim. Jemi të

vendosur që rinisë, sportit dhe kulturës t’ia japim përkrahjen e merituar për t’i mbështetur projektet e tyre në fusha të ndryshme. Shpresoj që mbështetja jonë të kthehet në

rezultate pozitive për komunën dhe qytetarët. Suksese të gjitha organizatave në synimet e tyre”, ka thënë kryetari i Deçanit, Bashkim Ramosaj.



A mund të hyjë ekonomia e Kosovës në recesion?



PRISHTINË, 28 MAJ - Ekonomia e Kosovës mund të hyjë në recesion si pasojë e inflacionit të lartë që ka goditur vendin dhe ka tkurrur aktivitetin ekonomik, kështu thonë për "Radion Evropa e Lirë", profesori i ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, Mejd Bektashi, dhe kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulëzim Rafuna. Recesioni përshkruhet si tkurrje e ciklit të biznesit dhe për pasojë ka rënie të përgjithshme të aktivitetit ekonomik. Rritja ekonomike reale në Kosovë, sipas Bektashit, nuk është më shumë se 2 deri në 3 për qind dhe kjo rritje, shton ai, "nuk mjafton për t'i ikur recesionit". "Problemi është se tani inflacioni, duke mos u stabilizuar me indeksimin e pagave, qoftë në sektorin publik apo privat, po shkakton një kërkesë më të ulët që mund të shpie në recesion", thotë Bektashi. Kosova, sipas të dhënave të Bankës Evropiane për Rindërtim

dhe Zhvillim (BERZh), në vitin 2022 ka shënuar rritje ekonomike 3.5 për qind dhe po aq është parashikuar të jetë gjatë këtij viti.

Gjermania në recesion ekonomik

Gjermania gjatë kësaj jave ka shpallur recesion në ekonomi si pasojë e inflacionit. Inflacioni në Gjermani ka prekur shifrën 7.2 për qind në prill. Ekonomia gjermane, sipas Zyrës së Statistikave, është tkurrur për 0.3 për qind në periudhën janar-mars dhe ka pasur një tkurrje prej 0.5-përqindësh në tre muajt e fundit të vitit të kaluar. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulëzim Rafuna, në fund të dhjetorit të vitit të kaluar, në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", kishte thënë se nëse tregu evropian hyn në recesion, ai automatikisht reflekton edhe në Kosovë. Tani kur ekonomia e Gjermanisë

është futur në recesion, Rafuna thotë se Kosova duhet të tregohet shumë e kujdesshme. "Në momentin që një vend evropian ka shënuar recesion, historia na ka treguar se ai reflekton edhe në Kosovë. Duhet të jemi të kujdesshëm dhe duhet ta përcjellim me kujdes trendin që të kalohet më lehtë", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë". Rafuna nuk dëshiron të komentojë se çfarë masash duhet të ndërmarrin institucionet e Kosovës për t'u përballuar më lehtë, nëse vendi futet në recesion.

BERZh-i: Kosova me rritjen ekonomike më të lartë në rajon

Sipas të dhënave të fundit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh), të publikuara më 16 maj, rritja ekonomike mesatare e vendeve të Ballkanit Perëndimor në vitin 2023 pritet të jetë 2.2 për qind,

ndërsa në vitin 2024 parashihet të rritet në 3.4 për qind. Kosova pritet ta ketë rritjen ekonomike më të lartën në rajon në vitin 2023 dhe 2024.

Por, profesori i ekonomisë, Mejd Bektashi, thotë se qeveria duhet të udhëheqë një politikë më liberale sa iu përket investimeve dhe rritjes së nivelit të pagave si në sektorin publik, po ashtu edhe në atë privat. Ai thotë se inflacioni i lartë ka goditur qytetarët, duke ulur fuqinë blerëse.

Inflacioni, 6.3 për qind

Në Kosovë, në muajin prill, sipas Agjencisë së Statistikave, inflacioni ka qenë për 6.3 për qind më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rritja e çmimeve vërehet te produktet ushqimore, lëndët djegëse, transport e të tjera, ndërsa norma mesatare e inflacionit në vitin 2022 ka qenë gati 12 për qind. Me inflacion të lartë Kosova është

duke u përballur nga fundi i vitit 2021.

Lidhur me perspektivën e inflacionit në Kosovë, Banka Qendrore e Kosovës parashikon që inflacioni në vitin 2023 të ngadalësohet në 5.4 për qind. Rritjes së inflacionit gjetkë në botë i kanë kontribuar në masë të madhe pandemia e koronavirusit dhe lufta e Rusisë në Ukrainë. Në zvogëlimin e ofertës së parave në tregun e Kosovës, sipas profesor Bektashit, ndikon niveli i ulët i pagave në Kosovë në krahasim me shtetet e Ballkanit Perëndimor. "Ne ende që dy vjet nuk e kemi caktuar pagën minimale", thotë ai.

Kuvendi i Kosovës më 14 qershor të vitit të kaluar ka votuar në parim një projektligj që hap rrugë për rritjen e pagës minimale: nga 130-170 euro sa është aktualisht, në 264 euro bruto, apo 250 euro neto.

Ky projektligj nuk është miratuar ende në Kuvendin e Kosovës.

Sipas Agjencisë Evropiane të Statistikave (Eurostat), Kosova është vendi me pagën më të ulët minimale në Evropë.

Paga mesatare në Kosovë në vitin 2021 ka qenë 484 euro. "Ky nivel i pagave shkakton uljen e aftësisë blerëse të qytetarëve që shkakton recesion në ekonominë kombëtare", thotë Bektashi.

Kur mund të ketë recesion?

Bektashi thotë se në periudhën kur pritet ardhja e diasporës nuk pritet të ketë recesion, pasi që ka një ngritje të sasisë së parave në ekonomi. Por, pas shkuarjes së diasporës në fund të muajve të verës, mund të paraqitet. "Mosinvestimi në rrugë, ruajtja e buxhetit të shtetit, duke i mbajtur paratë e ngrira, duke mos i investuar, mund të shkaktojë mungesë të parave që do të shprehet në sektorin e ndërtimit dhe tregtisë", thotë ai.

Sektorit i ndërtimit dhe ai i tregtisë janë dy nga sektorët me aktivitetin më të madh ekonomik në Kosovë. Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, vetëm vitin e kaluar remitencat kanë kapur vlerën e mbi 1.2 miliard eurove.

Shtëpia e Bardhë dhe republikanët arrijnë marrëveshje për tavanin e borxhit

WASHINGTON, 28 MAJ - Shtëpia e Bardhë dhe republikanët janë pajtuar në parim që ta rritin tavanin e borxhit të Shteteve të Bashkuara, duke shmangur kështu falimentimin pas disa javësh negociata. Marrëveshja tani duhet të miratohet nga Kongresi amerikan. Presidenti amerikan Joe

Biden e përshkroi marrëveshjen si "kompromis", ndërkaq kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve, Kevin McCarthy, tha se "ka një ulje historike të shpenzimeve". Më herët, Departamenti Amerikan i Thesarit kishte paralajmëruar se shteti do të mbeste pa para për t'i paguar faturat më 5 qershor nëse nuk do të arrihej një

marrëveshje. Një falimentim i tillë do ta përmbyste ekonominë amerikane dhe do t'i trondiste tregjet globale. Republikanët kanë kërkuar t'i shkurtojnë shpenzimet në fusha sikurse edukimi dhe programe të tjera sociale në këmbim të rritjes së tavanit të borxhit prej 31.4 trilionë dollarësh.



Simfoni metaforash të trishta

– Për librin me poezi të Xhevdet Bajrajt, “Kur engjëjt qajnë” –



Nga: Bardhyl ZAIMI

*(Pjesë nga libri me ese,
“Fuga e fjalëve”, 2004)*

Në kohën kur poezia është degraduar me prurje triviale, me këngëtime tashmë të ngjime nga poet pararendës të papërsëritshëm në vokacionin e tyre krijues, këngëtimi që sjell Xhevdet Bajraj me vëllimin poetik “Kur engjëjt qajnë”, na rikthen edhe njëherë tek poezia, tek fjala për të treguar se mund të shkruhet edhe ndryshe. Me të hapur këtë libër, ndjenjat tona njerëzore drejtohen plot spontanitet në thellësitë atdheut – zemër. Përnjëherësh ngjet të rrëmbehemi nga oshëtimat e shpirtit krijues, e fjalëve që pikturojnë nëpër faqet e këtij libri golgotën shqiptare, që vjen e freskët në ndërgjegjen tonë me ngjyrën dhe shijen e gjakut.

Lirikat që sjell në këtë libër krijuesi Xhevdet Bajraj,

pikturojnë me penelin e zemrës pamjet e skëterrshme që autori arrin t'i shkëlqoj nga përjetimi personal dhe kolektiv përmes një gjuhe bollshëm të figurshme. Gjatë këtij leximi, gjatë pjesëmarrjes në vlimin krijues të autorit, s'ke si të mos pajtohesh me vargjet e Ezra Paundit: “Vonë, tepër vonë të takova trishtim”. Përmes poetikës brilante, të ngjizur në thellësitë ku jeta me vdekjen përqafohen pandërprerë, krijuesi Xhevdet Bajraj na shkëlqon nga kafazi i argjendit të së tashmes për të na futur me forcën e tij krijuese në ndjeshmërinë më sublime të jetës, në rrathët e ferrit njerëzor prej nga ai merr brumin, ngjyrën dhe tonin e poezisë së tij.

Poezitë e këtij libri, si një zemër e vranë dhe e përgjumur rënkojnë dhimbshëm që të kumtojnë para ndërgjegjes njerëzore ëndrën e përgjakur, pulsimit e mjerë të jetës që rend të shpëtojë nga rruftja e lopës që kërkon ta kullotë.

“Me këpucë nga lëkura jonë /

Trishtimi ecën rrugëve të qytetit”, ky është paralajmërimi i trishtë që do të përcjellë këtë këngëtim fund e krye si një metaforë e ngritur për puqjen e jetës dhe të vdekjes. Mbi këtë teh vdekjeprurës, ku “Majmunët i kanë shkundur frytet / nga druri i ëndrës”, autori i revoltuar deri në pikëllim klith dhimbshëm: “Zorrëve të elitës politike / majmen skrajat”.

Kredoja e poetit nuk është pika e mbërritjes, por e kundërta, pika e nisjes për udhëtime metafizike, thotë J. Brodski, dhe pikërisht këtë bën edhe Xh. Bajraj, duke futur në lojë tërë forcën jetësore sensuale për të portretizuar denjësisht atdheun -zemër të vranë. Në kohën kur “Dita ballkanike i jep gjë bishës” dhe kur “Jeta si qen kruhet / Kur sheh njeriun rrugëve / Tek ecë dëgjueshëm / Pas fatit të vet”, autori ndjek një impuls jetik duke transponuar këtë mynxyrë në fjalë, metafora që rrëqethin me thellësinë e dhimbjes. “Derisa liria si nuse pret / ta

zbret dikush / nga kali i vdekjes” në këtë intermexo fatale, “Njerëzit ledhatojnë dhimbjet e tyre / në bregun e lumit të jetës”.

Duke stigmatizuar turpin njerëzor derisa “Brenda mureve të tejdukshëm të ëndrës / Dielli kalbet / Si zemra e kurvës”, sytë e vagëlluar të poetit kapin pamjet makabre të çmendisë njerëzore, autofrigoriferët që “bartën më dashurit tonë / të ngrirë nga vdekja”. Mu si L. Poradeci që besonte se “Toka është vendi ku shtrihet përjetësia”, edhe Xh. Bajraj do të shtrijë përjetësinë e vet në tokën e përgjakur të Kosovës, duke shpërfaqur para ndërgjegjes kolektive “klithmat e atyre që i varrosëm në zemrat tona; varret e vockla të fëmijëve që ikën në parajsë me nga një grusht plumba në gjoks; jetën e zbehur si fotografi e vjetër; hapat e rëndë të jetës...”. Tabloja e golgotës shqiptare, e portretizuar përmes ironisë të skajshme, kulminon me

poezinë “Gjellë shqiptare”, e cila dendëson brenda vetes skëterrën njerëzore. Këtu duket se përfundon emfaza krijuese e mbështjellë me tisin e jetë-vdekjes. Dhe, gjersa udhëtimi i tij krijues vazhdon “mbi valë pasthirmash / të derdhura detit të kohës”, sakaq, “nga dashuria që lëviz diellin dhe yjet e tjerë”, siç këndon Danteja, krijuesi anohet të dëgjojë këngën e mjellmës dhe të gjejë diellin e qiellit të tij, për të na dhuruar sakaq perlat e lirikës erotike që hapin një qiell tjetër para nesh brenda flakës së skëterrshme të dhembjes.

Në “Kënga e këngëve” thuhet se “e fortë si vdekja është dashuria”, dhe pikërisht përmes ndjeshmërisë së këtij poli tjetër, me “Kënga e Mjellmës” autori krijon “këngën e këngëve” që vjen si ngushëllim, si ngjyresë që plotëson këngëtimin e tij, duke na lënë hi në duar shpirtin e tij, i cili tundohet “gjer në jetën ku jeton jeta shqiptare”.

Epoka e “vogël” Akullnajore: Pse ndodhi një valë e të ftohtit ekstrem për 500 vite



Angli, gjysma e dytë e shekullit XIV. Valët e të ftohtit po shkatërron gradualisht të gjitha vreshtat dhe ullinjët në vend. Kjo seri ngjarjesh, do të ishte një pararojë e asaj që do të ndodhte gjatë 500 viteve të ardhshme. Klima do të ndryshonte aq shumë, sa që vetëm gjatë viteve të fundit, me ngrohjen aktuale globale, e shkaktuar kryesisht nga emetimet e gazrave serrë dhe ndotësve të tjerë nga njeriu, do t'i rikthehemi kultivimit të vreshtave në ato gjerësi gjeografike.

Vitet nga shekulli IX dhe deri në fillim të shekullit XIV-të u karakterizuan nga temperatura shumë të ngrohta. Dëshmitë dokumentare dhe shkencore, na tregojnë për një fazë të një klimeme një thatësi dhe temperatura të larta në Afrikë, Azi dhe Amerikën e Veriut.

Në këtë periudhë, nga Skandinavia, vikingët nisën eksplorimin me anijet e tyre drejt perëndimit, duke kolonizuar toka të shkreta më parë si Islanda (viti 874), Grenlanda (980) dhe sipas të dhënave të ofruar nga sagat nordike edhe në Amerikën e Veriut.

Leik Erikson, djali i vikingut të famshëm Eriku i Kuq, zbarkoi rreth vitit 1000 në një tokë që ata e quanin Vinland, ndoshta në ishullin Njufundlend në Kanadanë e sotme. Vini re emrat në vitin 874, kolonia e re u quajt “Iceland”, “toka e akullit”, ndërsa më pas u themeluan vendbanimet e quajtura “Greenland” (tokë e

gjelbër) dhe “Vinland” (tokë kullotash).

Natyrisht nuk mund të mendojmë se në ato gjerësi gjeografike ata kishin gjetur një bimësi të harlisur, por as klimën aktuale. Si provë e mëtejshme e atij të ngrohti anormal, hardhitë dhe pemët e ullirit u rritën në Angli. Nga viti 1300 çdo gjë nisi të ndryshojë. Akullnajat, që mëparë thuhet mungonin, u rikthyen duke mbuluar Detin e Veriut dhe malet.

Bora shfaqet në majat e Afrikës së Veriut dhe Timbuku, një qendër e rëndësishme karvanësh, që në harkun kohor prej 300 vjetësh, u përmyt plotësisht në të paktën 13 herë nga lumi Niger i fryrë nga shirat. Në Kinë, kriza e shkaktuar në mënyrë progresive nga klima e çmendur shkaktoi zi buke, që u pasuan nga revolta politike, të cilat në mesin e shekullit XIV, do të sjellin rënien e dinastisë Ming dhe ngjitjen në krye të perandorëve të dinastisë Qing.

Në Evropë pati valë të paprecedentë ngricash: Deti Baltik ngriu disa herë. Për shembull në janar 1658, ushtria suedeze marshoi mbi të nën drejtimin e mbretit Karli X për të sulmuar Danimarkën, si pjesë e Luftës së Dytë Veriore. Në Londër, panairi “Thames Frost Fair”, mbahej rregullisht gjatë dimrit, mbi lumin e ngrirë Tamiz.

Grenlanda dhe Islanda ishin plotësisht të mbuluara dhe të rrethuara nga akulli, dhe popullsia

e tyre u përgjysmua gjatë atyre viteve. Të famshme janë edhe pikturat e artistëve flamandë, që iportretizojnë peizazhet e Holandës aktuale të mbuluara tërësisht në dëborë.

Gjërat nuk shkuan më mirë as më në jug. Akullnajat pushtuan tokat dikur pjellore dhe të banuara, duke shkatërruar gjithçka. Stuhitë dhe përmytjet e shkaktuara nga shirat e dendur apo shkrija e borës, shkaktuan një katastrofë e vërtetë. Lisbona, kryeqyteti i Portugalisë, përfundoi 8 stuhi të rënda borë dhe ngrice gjatë shekullit XVII-të.

Zitë e bukës ndoqën njëra-tjetrën, duke goditur fort popullsinë evropiane. Njerëzit u detyruan të braktisnin kultivimin e bimëve që nuk i përshateshin më klimës së ndryshuar. Kështu ndodhi në Kinë me portokallet. Në disa vende mungesa e grurit, detyroi njerëzit të përzienin lëvozhgat e grimcuara të arrës me miellin e pakët për t'u ushqyer disi.

Si pasojë e kequshqyerjes dhe të ftohtit, epidemitë dhe murtajat ishin të shpeshta. Përballë këtij ndryshimi klimatik apokaliptik, njerëzimi reagoi duke u përshtatur me pëlhuara dhe veshje më të rënda që mbulonin më mirë trupin, dhe duke e përmirësuar arkitekturën e godinave, që u bënë më të orientuara drejt ruajtjes së nxehtësisë së brendshme.

Uri çoi edhe në akte të dhunshme: personat e dyshuar

për helmimin e ushqimit apo për përhapjen e sëmundjeve nëpërmjet magjive, përdorshin si “kokë turku” për situatën, duke shkaktuar kështu një gjueti shtrigash. Veç kësaj, luftërat dhe revoltat e shpeshta e goditën gjithë kontinentin tonë.

Ishte një periudhë padyshim e turbullt, e cila përfundoi vetëm në fundin e shekullit XIX, kur klima gradualisht hyri në fazën e tanishme, më të butë. Shkencëtarët kanë paraqitur teori të ndryshme për të shpjeguar këtë fenomen. Natyra ciklike e temperaturave të planetit tonë është diçka e njohur tashmë.

Ne e dimë nga burimet e lashta, se dimrat jashtëzakonisht të ftohtë ndodhin me një frekuencë mesatare prej rreth 300 vjetësh. Për shembull, kjo ndodhi në vitet 860 dhe 1162, edhe pse në atë kohë ishim në të ashtuquajturën fazë të periudhës së ngrohtë mesjetare.

Po ashtu është hipotezuar mbi aktivitetin diellor, veçanërisht fenomenin e njollave diellore. Këto zona të errëta në sipërfaqen e yllit tonë, të zbuluara nga Galileo në shekullin XVI, por tashmë të njohura edhe për astronomët kinezë, janë zona “më të ftohta”. Është vënë re se prania e njollave të Diellit është ciklike: çdo 11 vjet ose më shumë, ato reduktohen në mënyrë drastike.

Midis fundit të shekullit XVIII dhe fillimit të shekullit XIX,

shkencëtari dhe meteorologu anglez Xhon Dalton, vëzhgoi për herë të parë mungesën thuhet të plotë të njollave diellore. Në ato vite u regjistrua edhe viti pa verë (1816). Disa vjet më vonë, në fundin e shekullit XIX, shkencëtarët anglezë Eduard Uoller dhe Ana Maunder, interpretuan vëzhgimet e astronomëve midis viteve 1645–1715, duke zbuluar se në atë periudhë kishte rreth 15 njolla diellore të dukshme.

Normalisht vërehen disa mijëra. Dhe viti 1709 ishte një tjetër vit ekstremist i acartë. Ndërkohë në vitet para 1816–ës, ka pasur 3 shpërthime të fuqishme vullkanike, hiri i të cilëve errësoi atmosferën. Aktualisht ne vërejmë një “maksimum” të aktivitetit diellor, me stuhi të shpeshta magnetike që shkaktojnë Aurora borealis të mëdha dhe që ndikojnë negativisht; për shembull, telekomunikimet tona radio dhe satelitore, si dhe një rritje graduale e temperaturës.

Mund të arrijmë në përfundimin se ndoshta me ciklin e tij aktiviteti diellor, është të paktën një nga shkaqet e ndryshimit historik të klimës. Natyrisht, në përmytjen klimatike që po shohim vitet e fundit, është e dukshme “dora” e veprimtarisë njerëzore, që synon përfitimin në kurriz të ruajtjes së mjedisit. *Bota.al*

Marrë me shkurtime

Kush janë 10 qytetet më të mëdha në botë, atraksionet dhe sfidat e tyre



Nga James CUTMORE

Pasi popullsia globale arriti në 8 miliardë më 15 nëntor 2022, janë bërë parashikime të ndryshme se kur do të arrijë kulmin numri i njerëzve në Tokë. Studimet ndryshojnë, me disa që sugjerojnë se popullsia e botës do të arrijë 8.8 miliardë njerëz nga mesi i këtij shekulli, përpara se të nisë të bjerë.

Parashikime të tjera, si ato të OKB, vlerësojnë se popullsia e botës mund të arrijë më shumë se 10 miliardë deri në vitet 2080. Në çdo rast, rritja e konsiderueshme e popullsisë ka çuar në mbipopullim të konsiderueshëm në disa nga qytetet më të mëdha të botës, duke shkaktuar shqetësime madhore në lidhje me ndotjen dhe mbipopullimin. Ja cilat janë 10 qytetet më të populluara në botë, dhe si është të jetosh në to.

10. Osaka, Japoni: 19.2 milionë njerëz

Historikisht e rëndësishme si një qendër e tregtisë dhe industrisë, Osaka është ende një qendër financiare shtëpia e shumë kompanive të mëdha japoneze. Ajo është e famshme për kulturën e saj ushqimore dhe arkitekturën moderne, duke qenë shumë popullore për turistët.

Falë një sistemi të mirë të transportit publik, metroja arrin të transportojë mbi 900 milionë pasagjerë në vit. Por ashtu si me çdo mega-qytet modern, trafiku

mbetet një problem i madh për shkak të mbipopullimit. Problem është edhe strehimi.

9. Pekin, Kinë: 19.4 milionë njerëz

Qyteti i dytë më i madh i Kinës, është një nga më të vjetrit në botë. Këtu ndodhen shumica e bizneseve më të mëdha të vendit. Pekini ka aktualisht numrin më të madh të miliardërve në botë. Por për shkak të ndotjes industriale, stuhive të shpeshta të rërës dhe gazrave të makinave, shumë banorëve u thuhet shpesh të qëndrojnë brenda për të shmangur rreziqet e mundshme shëndetësore.

8. Mumbai, Indi: 20.1 milionë njerëz

I ndërtuar mbi 7 ishuj, Mumbai është një qytet historik, plot me kulturë dhe art. Këtu ndodhet qendra e industrisë së filmit indian (Bollywood). Po ashtu është kryeqyteti tregtar dhe financiar i Indisë. Dhe po këtu e kanë selinë shumica e kompanive më të mëdha, gjë që ka sjellë një fluks të madh njerëzish që vijnë nga zonat rurale.

Problemet kryesore janë higjiena e dobët dhe strehimi me cilësi të ulët. Mumbai ka rrugët më të mbingarkuara në botë, kryesisht për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe një sistemi transporti publik që nuk është në

gjendje të përballojë fluksin.

7. Dhaka, Bangladesh: 20.2 milionë njerëz

Kryeqyteti i Bangladeshit po rritet me një ritëm të shpejtë, i nxitur nga një industri botuese e lulëzuar. Po ky qytet historik është qendra e kulturës bengaleze. Këtu organizohen festivale të panumërta të artit dhe ceremoni fetare gjatë gjithë vitit. Po për shkak të pozicionit të saj në deltën e Gangut, Dhaka është e prirur ndaj përmbytjeve të shpeshta gjatë sezonit të musonit dhe cikloneve.

6. Kajro, Egjipt: 20.4 milionë njerëz

Përveç arkitekturës së famshme historike, Kajro njihet si shtëpia e njërës prej mrekullive të lashta të botës; kompleksit të piramidave të Gizës së lashtë. Këtu banon 11 për qind të popullsisë së vendit. Aktualisht është në plan një projekt që do të ndihmojë në lehtësimin e problemeve të rëndësishme të trafikut.

5. Mexico City, Meksikë: 21.6 milionë njerëz

Ndodhet në pllajën e njohur si Lugina e Meksikës, 2240 m mbi nivelin e detit dhe është kryeqyteti më i vjetër në Amerikë. Zhvillimi i këtij metropoli është i jashtëzakonshëm. Në vitin 1900, popullsia e tij ishte vetëm 500.000

banorë. Por për shkak të një numri të madh njerëzish që erdhën nga zonat rurale në kërkim të punës, ky numër u rrit në 9 milionë deri në vitet 1970.

Për shkak të mungesës së banesave, ky fluks detyroi një numër të madh njerëzish të ngrinin banesa pa leje. Sot Mexico City është tani një qendër e madhe biznesi dhe një atraksion turistik popullor, plot me muzeume dhe me vende të këndshme për të ngrënë.

4. São Paulo, Brazil: 21.8 milionë njerëz

Është një qytet i kontrasteve të mëdha. Varfëri ekstreme përballë një pasurie të madhe. Rrokaqiejt e mëdhenj të zonës financiare ngrihen mbi lagjet e varfra të qytetit, të njohura si favela. Problem i madh është furnizimi me ujë të pijshëm. Gjithsesi vitet e fundit ka pësuar një rënie të kriminalitetit, ndërsa është përmirësuar cilësia e ajrit.

3. Shanghai, Kinë: 26.3 milionë njerëz

Shumë vite më parë, ishte qenë një fshat i vogël peshkatarësh. Por falë vendndodhjes së tij pranë grykëderdhjes jugore të lumit Jance, u bë dalëngadalë qyteti më i madh në Kinë, dhe një nga më të mëdhenjtë në botë. Aty ndodhen disa qendra tregtare të mëdha moderne, por edhe restorante që ofrojnë ushqimin tradicional kinez.


2. Delhi, Indi: 29.30 milionë njerëz

Vetë qyteti ka ekzistuar prej më shumë se 2000 vjetësh, gjë që shkakton grupin e vet të problemeve. Infrastruktura është e vjetruar, edhe pse kohët e fundit ka pasur shumë projekte të ndërtimit të rrugëve, që kanë ndihmuar në lehtësimin e trafikut. Problem madhor është ndotja nga rrugët dhe industria, por edhe standardi i dobët i banesave, ku jeton 50 për qind e popullsisë.

1. Tokio, Japoni: 37.4 milionë njerëz

Metropoli i Tokios shtrihet në një sipërfaqe prej vetëm 13.452 km², me një dendësi 2.642 njerëz në çdo km². Kjo paraqet probleme për banorët e saj për sa i përket hapësirës së jetesës dhe udhëtimit. Mungesa e banesave të lira është një problem akut. Ndaj apartamentet e vogla me sipërfaqe vetëm 9 m² po bëhen gjithnjë e më të preferuara në mesin e banorëve të rinj, që përpigjen të vendosen me banim pranë qendrës së qytetit për punë.

Edhe shëtitja nëpër qytet është gjithashtu shumë problematike. Rrugët shpesh janë të tejmbushura. Edhe transporti publik është gjithashtu shpesh i mbipopulluar dhe i shtrenjtë, megjithëse është pothuajse gjithmonë në orar. / "Science Focus" – Bota.al



Ballkani feston titullin, Trepça '89 dhe Drenica bien nga Superliga

Klubi nga Suhareka, Ballkani vazhdon të shkruaj historik duke e fituar për herë të dytë radhazi titullin e kampionit në elitën e futbollit të Kosovës. Në vend të dytë përfundoi Drita me tri pikë me pak, derisa nga Superliga kanë rënë Drenica dhe Trepça '89, kurse Ferizaj do të luaj në barazh

EPOKA
ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 28 MAJ - Skuadra e Ballkanit është kurorëzuar me titullin e kampionit për edicionin e garave 2022/23 në Superligën e Kosovës në futboll. Në këtë mënyrë skuadra nga Suhareka e feston titullin e dytë në elitë, derisa në ndeshjen e fundit kundër Gjilanit luajti baras 0-0. Trofeun e kampionit për dy kapitenët e skuadrës, Edvin Kuç dhe Armend Thaçi e dorëzuan presidenti Agim Ademi së bashku me kryetarin e Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj dhe drejtorin gjeneral të Albi Mall, Sutki Humolli, derisa medaljet për kampionët i ndanë edhe anëtarët e KE të FFK-së, Mirsad Çollaku dhe sekretari i përgjithshëm, Taulant Hodaj. Ballkani e mbrojti titullin e kampionit, duke e mbyllur edicionin me 73 pikë, tri më shumë se përcjellësja më e afërt Drita. Gjilani e përfundoi kampionatin në pozitën e tretë. Ndërsa nga elita janë larguar Drenica dhe Trepça '89. Kuqezinjtë më herët kishin humbur gjasat për mbijetesën, derisa Trepça '89 në ndeshjen e

fundit arriti fitore ndaj Prishtinës me rezultat 2-1, por nuk arriti mbijetesën për faktin se në anën tjetër Ferizaj e mposhti Dukagjinin e Klinës (2-1), në një ndeshje mjaftë të përfolur. Në ndeshjen e barazhit për mbetje në Superligë do të luajë Ferizaj kundër skuadrës nga Liga e Parë, Lirisë. Në xhiron e fundit fitore realizoi edhe Malisheva në përballje me Llapin me rezultat 3-2, derisa kuqezinjtë e Drenicës pësuan nga Drita me rezultat 1-3.

Ademi: Urime titulli i kampionit FC Ballkani

Agim Ademi, kryetar i Federatës së Futbollit të Kosovës: "Për herë të dytë radhazi skuadra, kurorëzohet me titullin e kampionit në Albi Mall Superligën e Kosovës! Skuadra që na bëri krenarë me paraqitjet e saj në garat evropiane, edhe në këtë kampionat dëshmoi cilësi dhe dëshirë të madhe për sukses, gjë të cilën e konkretizoi me titullin e dytë të merituar. Sot së bashku me kryetarin e Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, drejtorin e sponsorit të Superligës, Albi

Mall, Sutki Humolli, anëtarin e KE të FFK-së, Mirsad Çollaku dhe sekretarin e përgjithshëm, Taulant Hodaj, i ndamë medaljet dhe trofeun për ekipin kampion, në ceremoninë zyrtare në një atmosferë imponante në Stadiumin e Qytetit në Suharekë. Përgëzoj futbollistët, stafin e trajnerëve, drejtuesit e klubit dhe të gjithë qytetarët e Suharekës për këtë arritje, duke uruar që FC Ballkani të ketë një tjetër prezantim të jashtëzakonshëm në garat evropiane".

SUPERLIGA

Gjilan - Ballkani	0-0
Trepça '89 - Prishtina	2-1
Drenica - Drita	1-3
Malisheva - Llapi	3-2
Ferizaj - Dukagjini	2-1

Tabela

1. Ballkani	73 pikë
2. Drita	72
3. Gjilani	54
4. Dukagjini	50
5. Prishtina	48
6. Malisheva	46
7. Llapi	43
8. Ferizaj	41
9. Trepça '89	40
10. Drenica	23

SHKURT

Verstappeni triumfon në Çmimin e Madh të Monacos

Max Verstappen nuk fal. Piloti i njohur holandez ia ka dalë të fitojë çmimin e madh të Monacos, në një ditë që rezultoi të ishte mjaft e mirë për të. Verstappen dhe Red Bull i tij zhvilluan një garë fantastike, duke u pozicionuar kështu në vendin e parë me meritë. Në pozicionin e dytë është spanjoli Fernando Alonso, ndërsa top-3 mbyllet nga Esteban Ocon. Më pas vijnë Hamilton dhe Rusell, që duhen të kënaqen me vendin e katërt dhe të pestë. Formula 1 dhuroi emocione të mëdha për të apasionuarit këtë fundjavë, duke i mbajtur të gozhdur para ekranit deri në sekondën e fundit.

Pochettino nënshkruan me Chelsea

Mauricio Pochettino do të jetë trajneri i ardhshëm i Chelseat. Sipas gazetarit të njohur, Fabrizio Romano, argentinasi tashmë e ka nënshkruar kontratën me "Blutë", pas marrëveshjes verbale të arritur dy javë më parë. Edhe njoftimi zyrtar nga Chelsea pritet të bëhet së shpejti. Pochettino do të fillojë punën si trajner i skuadrës londineze javën e ardhshme. Ai ka nënshkruar kontratë të vlefshme deri në qershor të vitit 2026. Kujtojmë se 51-vjeçari ishte pa skuadër që nga vera e kaluar, kur u shkarkua nga Paris Saint-Germaini. Pochettino në të kaluarën ka drejtuar edhe Tottenham Hotspur, Southampton e Espanyol.

Messi, lojtari më i dekoruar në futboll

Leo Messi nuk ndalet së thyeri rekorde në botën e futbollit. Messi është bërë lojtari më i dekoruar në histori të futbollit, së bashku me Dani Alves. Të dy tashmë numërojnë nga 43 tituj. Titullin e 43-të në karrierë, Messi e fitoi mbrëmë në barazimin (1-1) të PSG me Strasbourg, që në fund klubi parisien u shpall kampion i Francës. Argentinasi po ashtu është bërë golashënuesi më i mirë në histori në top-pesë ligat evropiane me 496 gola. Duke kaluar kështu Cristiano Ronaldo i cili kishte 495. Messi pritet të largohet së shpejti nga Paris Saint Germain. E ardhmja e tij mund të jetë në Barcelonë, Arabi Saudite, apo edhe në Amerikë.

Hysaj shënon, Lazio triumfon ndaj Cremoneses

Lazio ka marrë një fitore të rëndësishme 3-2 ndaj Cremoneses në shtëpi, në sfidën e javës së parafundit të kampionatit. Takimi u zhblllokua që në minutën e katërt me Elseid Hysaj, ndërsa brenda fraksionit Saviq dyfishoi shifrat. Mysafirët nuk u dorëzuan dhe ia dolën të barazonin shifrat. Galdames ngushtoi diferencat, sakaq skuadra e Sarrit ishte e pafat pak më pas pasi Lazzari shkaktoi autogol. Kur sfida po shkonte drejt barazimit, ish-lojtari i Interit, Vecino i jep 3 pikë ekipit kryeqytetas. Lazio renditet në vendin e dytë, Cremonese do luajë në Serie B sezonin tjetër.

Khaka shënon dy gola, Arsenali përfundon në pozitën e dytë

LONDËR, 28 MAJ - Arsenal ka fituar me rezultat 5-0 kundër Wolverhamptonit. Dy prej

golave i realizoi mesfushori shqiptar Granit Khaka. Ai shënoi në minutat 11 dhe 14-të. Golat

tjerë për Arsenalin i shënuan Saka, Jesus dhe Kiwior. Skuadra e Mikel Artetas, përfundoi në

vendin e dytë me 84 pikë, gjashtë më pak se Manchester City që u shpall kampion i Premier Ligës.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjeipuneshejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Mirlinda Fetahu nga Prishtina, shpall të pavlefshme dëftesat, certifikatën e notave dhe diplomën e lëshuar nga shkolla e mesme Sh.M.T.H.T "7 Shatori", Prishtinë.

- Albin Ahmeti shpall te pavlefshme dëftesat 6 deri 9 te shkollës fillore "Migjeni".

- Besmir Haxhikadrija nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl.I,II,III,IV dhe diplomën e shm.m. Ekonomike " Kadri Kusari. Gjakovë.

- Myrvete Krasniqi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Mjekësisë " Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Nexhat Xhemaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Fadil Hisari " Prizren.

- Gentiana Gashi shpall te pavlefshme dëftesat , certifikatën , diplomën QK "11 Marsi " Prizren.

- Andi Haxhiu nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Sadri Berisha nga Lipoveci KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. Shaban Gola" nga kl. I-V dhe VI-IX Lipovec.

- Alban Miftari nga Gjkova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Vildane Braha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Tekstil.

- Astrit Duraku shpall të pavlefshme dëftesat, diplomën si dhe certifikatën e maturës të shkollës "Hoxhë Kadri Prishtina" Prishtinë.

- N.T.SH "FIBELLO" Shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 810558330.

- N.T.SH "FIBELLO" shpall te pavlefshme certifikatën e TVSH-SE me numër 330217564.

- N.T.SH" FIBELLO" shpall te pavlefshme certifikatën e numrit fiskal me numër "600694732.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

